

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 12-2016

PROJEKTIMI I NDËRTESESË SHQËRORE SHKOLLË FILLORE

Fat Deva

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Architecture Commons](#)

Recommended Citation

Deva, Fat, "PROJEKTIMI I NDËRTESESË SHQËRORE SHKOLLË FILLORE" (2016). *Theses and Dissertations*. 522.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/522>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.

1. Hyrje

Shkolla perfaqeson një institucion të organizuar dhe të specializuar për arsimimin e çdo individi. Ajo vepron si një qender mësimi në bashkëpunim të ngushtë me organizma të tjerë shoqëror dhe ka ndikim të madh në shoqërinë e çdo vendi.

Shkollat e para janë themeluar ne Kine, Indi, Egjipt, Babiloni, Mesapotami, Persi, Greqi, Rome etj. që në shek. IV para erës së re.

Përhapja e shkollës dhe e sistemit të arsimit në Kosovë, pas përpjekjeve të mëdha, fillon në shek. XIX, me hapjen e shkollave në Prizren, Gjakovë dhe Pejë, si dhe shkollës fillore për djem dhe vajza në Prizren. Në Kosovë shkolla e parë shqipe hapet në Stubëll, në vitin 1905.


Nga viti 1999 deri më 2006 nga buxheti i Kosovës janë riparuar 39 objekte shkollore dhe janë ndërtuar 28 objekte të reja. Sipas MASHT-it, llogaritet se Kosovës i nevojiten së paku edhe 30 objekte të reja dhe riparimi i shumë objekteve të tjera, gjendja e të cilave nuk u përshtatet normave për zhvillimin e procesit arsimor.

Sistemi aktual i arsimit në Kosove ngërthen në vete këto nivele të arsimit:

1. Arsimi parashkollor - parafillor i cili përfshin tri nivele :
 1. Çerdhja (për fëmijët e moshës 1-2 vjeçare),
 2. Kopshti (për fëmijët e moshës 3-4 vjeçare) dhe
 3. Klasa parafillore (për fëmijët e moshës 5 vjeçare)
2. Arsimi fillor (pesë klasor) - shkalla 1 sipas ISCED, (kl. I - V) dhe përfshin fëmijët e moshës 6 - 11 vjeç.
3. Arsimi i mesëm - ngërthen të rinjët nga mosha 11 - 18 vjeç, me dy nivele:
 1. Arsimi i mesëm i ulët (katërvjeçar), shkalla 2 sipas ISCED, (mosha 11 - 15 vjeç)
 2. Arsimi i mesëm i lartë (tre dhe katërvjeçar), shkalla 3 sipas ISCED, (mosha 15 - 18 vjeç)
4. Arsimi universitar me tri nivele studimi:
 1. Shkalla e parë - Bachelor
 2. Shkalla e dytë - Master (MA) dhe
 3. Shkalla e tretë - Doktoraturë (Ph.D.)


Objekti shkollor që kam përzgjedhur ta projektoj, i përket niveleve të arsimit 1, 2 dhe 3.1.

2. Analiza e Lokacionit



Lokacioni i përzgjedhur gjendet në Kosovë, përkatesisht në Komunën e Gjakovës, saktësisht në fshatin Ponoshec i cili është njëri ndër fshatrat më të mëdha të kësaj Komune.


Ky lokacion gjendet afër nyjes lidhëse (udhëkryqit) mes rrugës rajonale R 109 Gjakovë-Junik-Deqan-Pejë dhe rrugës magjistrale M 9-1 ndërshtetërore Kosovë-Shqipëri. Është në pjesën qendrore të fshatit, i rrethuar kryesisht me shtëpia individuale të banimit me etazhitet P dhe P+1, nuk ka banim kolektiv dhe shumica e parcelave në afërsi janë toka të punuara dhe të industrisë bujqësore.



Tereni i lokacionit është kryesisht i rrafshët.

Në të gjenden objekti egzistues i shkollës fillore “Ganimete Terbeshi” me etazhitet P+1, i përcjellur me kthinat tjera si: Salla e arsimitarëve dhe nyjet sanitare të cilat janë të ndara nga objekti kryesorë.

Në kuadër të lokacionit është edhe tereni sportiv për futboll të vogël.



Pamja e paraqitur më lartë tregon fluksin e automjeteve dhe siluetën.

Vërehet se fluksi më i madh është tek nyja lidhëse në afërsi të shkollës, gjë e cila e bënë rrugën e shkollës mjaftë të qarkullueshme dhe të zhurmshme. Shtrirja e objekteve të ndërtuara, është më e koncentruar në anën veriore dhe jugore të lokacionit, përderisa anët lindore dhe perendimore janë më pak të ndërtuara.

Hyrja kryesore për në lokacion është nga ana lindore, drejtëpërdrejtë nga rruga e frekuentueshme e cila lidhë Gjakovën me Junikun. Nga kjo hyrje nuk vërehet hyrja kryesore e objektit (shkollës). Është e vetmja hyrje për në lokacion, të gjitha anët tjera janë të rrethuara me gardh, Nuk ka materializim por është në gjendje të keqe, ka mungesë të parkingjeve, si dhe hyrjeve ekonomike dhe administrative.



3. Arsyeja e zgjedhjes së lokacionit



Objekti egzistues është në gjendje të mjerueshme i cili nuk i plotson standardet e ndërtimit dhe kushtet për mësim cilësor. Sic shihet nga fotot objekti ka dëmtime të mëdha në disa pjesë të mureve, dyerve, dritareve. Materialet e përdorura nuk janë adekuate të cilat nuk i përballojnë



kushteve klimatike. Përveq kësaj, salla e arsimtarëve dhe nyjet sanitare janë të ndara nga objekti kryesor ku gjinden klasët mësimore, që do të thotë që për nevoja të ndryshme duhet dalur në ambientet e jashtme për të qarkulluar në këto kthina. Prandaj kemi ardhë në perfundim të rindertimit të këtij objekti shkollor sipas standardeve të ndërtimit dhe kritereve që mundësojnë mesim cilësor. Sa i përket pjesës së jashtme të objektit (oborrit) shohim një mosorganizim të hapësirave përbërse të oborrit siq janë shitgjet për ecje, hapsirat për pushim, rekreacion dhe sport, hapësirat gjelbruese etj.

4. Analiza SWOT

Përparësitë

- Pozita e mirë gjeografike e lokacionit
- Qasja e lehtë për në lokacion
- Infrastruktura e kompletuar
- Mundësi edukimi
- Numri i mjaftueshëm i nxënësve
- Kuader i mjaftueshëm për mësimdhënje

Mangësitë

- Afërsia e hollës me rrugën
- Gjelbërimi jo I mjaftueshëm
- Sipërfaqe e vogël e lokacionit
- Mungesa e parkimit
- Mungesa e shtigjeve për këmbësorë
- Mungesa e kabineteve
- Lidhja joadekuate mes hapësirave
- Objekti shumë I vjetër
- Mungesa e hapësirës për shumë qëllime
- Nuk ka kushte higjeno-teknike
- Nuk ofrohet mësim didaktit
- Mirëmbajtja e vështirë

Mundësitë

- Krijimi i hapësirave të lira brend dhe përreth lokacionit
- Zgjerimi i lokacionit
- Përmirësimi i mësimnxënies perms kabineteve përcjellëse
- Harmonizimi i hapësirave
- Definimi i hyrje dljeve për në lokacion

- Ndërtimi i shkollës së re sipas normave dhe standardeve bashkëkohore
- Krijimi I hapësirave për shumë qëllime
- Ngritje e cilësisë për mësim
- Tërheqja e vëmendjes së nxënësve përmes kriimit të hapësirave të reja

Rreziqet

- Kosto e lartë e ndërtimit
- Zvogëlimi i numrit të nxënësve si pasojë e migrimit të popullsisë
- Ngecje në vijueshmërinë e edukimit të nxënësve deri në ndërtimin e objektit të ri
- Mospërkrahja e projektit nga autoritetet komunale
- Mos vendosja e Arsimit si prioritet nga autoritet komunale

Përmbledhje :

Në bazë të analizës së gjendjes ekzistuese dhe elaborimit të saj përgjatë SWOT analizës, vijmë në përfundim se nevojitet ndërtimi I një shkolle të re sipas standardeve, pasi që shkolla ekzistuese nuk I plotëson kushtet dhe ka mungesë të elementeve bazë për mbajtjen e mësimi cilësor dhe efektiv. Ka mungesë të kabineteve, kushteve higjeno-teknike, vjetërsia e objektit etj.

Me ndërtimin e një shkolle të re, do të kemi mësim më cilësor dhe interesim të nxënësve më të madh për mësimnxënie.

5. Përshkrimi Teknik për Ndërtesën Shoqërore – Shkollë Fillore

Lokacioni: **Ponoshec, Gjakovë**

Objekti: **Shkolla Fillore “ Ganimete Terbeshi ”**

Parcelat nr: **00330-0, 00331-0, 00332-0, 0033 3-0**

5.1 Analiza Arkitektonike

Ndërtesa e re e Shkollës Fillore “ Ganimete Terbeshi” planifikohet të ndërtohet në parcelat me nr. 00330-0, 00331-0, 00332-0, 0033 3-0, Zona Kadatrale Ponoshec, në vendin e njejtë ku është edhe Shkolla egizstuese (e cila duhet të rrënohet për arsye se nuk i plotëson kushtet bazike për këtë funksion.

Ndërtesa e projektuar ka formë të rregulltë.

Kyqja për në Shkollë, është nga ana Veri – Lindore, përkatesisht nga rruga kryesore që lidhë fshatrat Ponoshec dhe Junik.

Parcelat nga të tri anët e tjera janë të rrethuar me gjelbrim të ulët dhe të lartë.

Perrethë lokacionit ka edhe objekte të tjera të banimit individual me etazhitete B+P, B+P+1, B+P+2, të cilat janë në formë katrore dhe drejtëkëndëshe. Në afersi të parcellës gjendet edhe Zyra e Vendit e Komunës së Gjakovës.

5.2. Funksioni i ndërtesës

Në ndërtesën shoqërore Shkolla Fillore “ Ganimete Terbeshi” kemi një kombinim të funksioneve si: mësim klasor për nxenës, studim në kabinete, qëndrim ditor për parashkollor, deponimi, dhe funksione të tjera teknike. Të gjitha këto funksione janë komplementare mes veti dhe e rrisin kualitetin e mësimin në këtë ndërtesë.

5.3. Përmbajtja e ndërtesës

Ndërtesa shoqërore Shkolla Fillore “ Ganimete Terbeshi” do të ndërtohet në shtrirje Lindje, Jug dhe Perendim 15 (shkallë).

Për projektimin – dimensionimin e kësaj ndërtese, kemi shfrytëzuar Literaturën (Noifert), si dhe jemi bazuar në normat dhe standardet ndërkombetare.

Etazhitei i këtij objekti është B+P+1E, ku funksionet e ndryshme janë të ndara nëpër etazha,si:

4.3.1. Bodrumi	- Sipërfaqja Neto	397 m ²
4.3.2. Perdhesa	- Sipërfaqja Neto	1123 m ²
4.3.3. Kati i Parë	- Sipërfaqja Neto	979 m ²

5.3.1. Bodrumi

➤ Depo për material shpenzues	45 m ²	
➤ Inventari i ri	71 m ²	
➤ Inventari i vjetër	71 m ²	
➤ Punëtorja	53 m ²	
➤ Nënstacioni i Ujit	16 m ²	
➤ Nënstacioni i Rrymës	16 m ²	
➤ Nënstacioni i Nxemjes	34 m ²	
➤ Arhiva	36 m ²	
➤ Kthina për Mirëmbajtje		21 m ²
➤ Shtëpiaku 12		
➤ Nyjet Sanitare – 1 për femra + 1 për meshkuj		6 m ²
➤ Komunikimi Vertikal – Shkallët dykrihëshe		16 m ²

Ashensori 150 x 230

5.3.2. Përdhesa

➤ Hyrja Kryesore

- Erëmbrojtesi 44 m²
- Sigurimi 6 m²
- Hapësira për shumë qëllime 280 m²
- Nyjet sanitare për femra 15 m²
- Nyjet sanitare për meshkuj 18 m²
- Nyjet sanitare për hendikep 4 m²
- Kuzhina + Depo 32 m²
- Tryezaria 63 m²
- Klasat – 6 klasa me nga 24 nxënës, 1 klase 51 m²
- Komunikimi vertikal për nxënës
 - Shkallët dykrihëshe 22 m²
 - Ashensori 140 x 280

➤ Hyrja për Parashkollorë

- Erëmbrojtesi 16 m²
- Nyjet sanitare për femra 15 m²
- Nyjet sanitare për meshkuj 18 m²
- Nyjet sanitare për hendikep 4 m²
- Klasa për parashkollorë 1 klasë 51 m²
- Kuzhina + Depo 8 m²
- Tryezaria 41 m²
- Hapësira për fjetje 102 m²
- Këndi i lojrave 48 m²

➤ Hyrja Administrative dhe Ekonomike

- Erëmbrojtesi 9 m²
- Komunikimi Vertikal – Shkallët dykrihëshe 16
- Ashensori 150 x 230

5.3.3. Kati i parë

- Salla e Arsimitarëve 44 m²
- Nyjet sanitare për femra 15 m²
- Nyjet sanitare për meshkuj 18 m²
- Nyjet sanitare për hendikep 4 m²
- Pedagogu 16 m²
- Sekretari 16 m²
- Drejtori 28 m²
- Sekretarësha 18 m²
- Salla e takimeve 20 m²
- Kabinet 1 51 m²
- Kabinet 1 51 m²
- Kabinet 1 51 m²
- Kabinet 1 51 m²
- Komunikimi Vertikal për nxenes
 - Shkallet trikihëshe Ashensori 22 m²
 - Ashensori 140 x 280
- Komunikimi Vertikal për arsimtare
 - Shkallët dykihëshe 16 m²
 - Ashensori 150 x 230
- Terasa për nxenes 558 m²

5.4. Kontruksioni i ndërtesës

Sistemi konstruktiv i ndërtesës është sistem skeletor, prej shtyllave të betonit të armuar, trajeve të betonit të armuar dhe pllakës masive prej betonit të armuar. Shtyllat janë të projektuara si panelle të betonit të armuar, me dimensione 30cm x 30cm.

Shtangimin e ndertesës gjithashtu e ndihmon edhe konstruksioni i ashensorëve si dhe përgjithësisht muret e betonit përreth shkallëve, duke e formuar kësi soji një bërthamë të objektit. Pllaka e meskateve ka trashësinë e betonit 20 cm.

Themelet e objektit janë të tipit themele të vequara, të funduara në thellësi të tokës. Nën themele është paraparë fillimisht të bëhet stabilizimi i terrenit me zhavor të granulatit të mesëm dhe të madh në trashësi prej 20cm. Gjithashtu, për shkak të rrezikut nga ujërat nëntokësore është paraparë të bëhet drenazhimi nën themele, ku trupi i drenazhës do të mbushet me zhavor të granulatit të mesëm.

5.5. Muret e Jashtme - Fasada

Mbyllja e objektit është paraparë të bëhet me mure prej bllokave të argjilës me trashësi 25 cm. Nje pjesë e tyre do të jenë të veshura me panele të drurit të lameluar, që të rrezistoj kushteve atmosferike, ndërsa pjesa tjetër do të jetë fasadë strukturale.

Është paraparë që të përdorim Demit fasadë–me stiropor të trashësis 10cm,ku pas shtrëngimit me rrjetë rabric (PVC),punohet edhe fasada (afërsisht 3mm) e ngjyrosur me RAL 7001, apo të ngjajshme.

5.6. Muret e Brendshme

Muret e brendshme që do të ndajnë hapësirat mes veti do të jenë nga blloqet e argjillës me trashësi 20 cm, dhe 10 cm, dhe më pas do të suvatosen me llaq vazhdues. Tavani do të jetë Pllafon i lëshuar në të cilin do të vendosen edhe trupat ndriques.

Për çdo nyje sanitare janë paraparë kanalet e ventilimit me elemente “schunt”, ku pranë tyre janë paraparë edhe kanalet vertikale për kalimin e gypave të ujës-jellësit dhe kanalizimit dhe eventualisht ata të ngrohjes.

Gjithashtu janë paraparë që në bodrum të kryhen të gjitha hidroizolimet horizontale dhe vertikale, me materiale të qëndrueshme ndaj bymimit dhe tkurrjes, ndërsa nëpër banjo duhet të bëhet edhe izolimi I ftohtë.

5.7. Suvatimi

Suvatimi i mureve të brendshme duhet të bëhet me suva të gatshme (prodhime knaufi-MP, Renova ose ngjashëm). Pas përfundimit të fazës suvatuese mund të bëhet ngjyrosja dhe dekorimi i hapësirave (kryesisht me ngjyra dispersive), varësisht prej projektit të enterierit.

Muret në kthina të banjës dhe kuzhinës duhet të finalizohen me pllaka të qeramikes, ku muret e banjës deri në lartësinë e pllafonit.

5.8. Kulmi

Konstruksioni i kulmit është kulm i gjelbërt i pashfrytëzueshem dhe i shfrytëzueshem, i rrethuar me pllaka betoni për levizje dhe mirmbajtje të kulmit. Ka ramje në të dy anët e kulmit një ramje prej 2 % , për largimin e ujrave nga të reshurat atmosferike, kulm ky i cili ruan freskinë e objektit si dhe nga aspekti arkitektonik rritjen e kualiteti të ndertesës.

5.9. Zdrukhtaria

Dritaret janë prej PVC TROCAL, 70x80mm, me xhamëzim termopan 4+12+4 mm. Sistemi i dritareve-WURTH system (sistem gjerman), ndërsa sistemi i mbylljes ROTO system.

Mbyllja bëhet me dy diktuna, sipas skemave të prodhuesit.

Dyert e brendshme janë të standardit DIN, të ndërtuara nga pllaka MDF, të furniruara dhe të ngjyrosura, të pajisur me mekanizma dhe dorëza të inoxit. Montimi i dyerve është i thatë dhe duhet të bëhet në fund, pas dekorimit të mureve.

Të gjitha pozicionet e zdrukhtarise janë parapare sipas normave dhe standardeve nderkombetare.

5.10. Dyshemeja

Dyshemeja e objektit do të jetë e ndryshme , varësisht nga funksioni i hapësirave. Në erëmbrojtës, hapësiren për shumë qëllime, koridore , tryezari dhe pjesën për komunikim , do të

përdoret graniti jo i rrëshqitëshëm, me trashësi 3 cm, për arsye së lehtë mirëmbahet. Në hapësirat e klasave në dysheme do të përdoret materiali i parketit, për arsye se është me i ngrohët, ndërsa në pjesën e kuzhinës, dhe nyjeve sanitare do të përdoren pllaka të keramikës.

5.11. Komunikimi Vertikal

Komunikimi vertikal do të behët me shkallë dhe me ashensorë. Do të kemi dy hapësira të komunikimit vertikal, 1 për nxënës dhe një për arsimtarë.

5.12. Kulmi

Kulmi i ndërtesës do të jetë kulm i rrafshët, me një ramje prej 5 %, e cila ramje do të shërbeje për largimin e ujrave atmosferik.

5.13. Rekreacioni

Në oborrin e shkollës do të ndërtohet një fushë e cila do të shfrytëzohet për futboll të vogël, dhe për basketboll. Diensionet e fushave janë paraparë sipas standardeve.

Përrreth fushës sportive do të ketë edhe staza për vrapim.

Hapësirat për argëtim dhe rekreacion, do të përcjellen edhe me sipërfaqe gjelbëruese

Tek pjesa e hyrjes për parashkollorë do të ketë edhe kënd për lojra

5.14. Parkingjet

Në parcellë janë paraparë të kemi dy vend parkingje

Një për prindër, me 7 parkingje, dhe

Një për Arsimtar me 9 parkingje

Të dy këto parkingje, kontrollohen me rampë e cila është e vendosur në hyrje.

6. Konkluzion

Idea për të projektuar këtë Shkollë fillore është rrjedhojë e nevojës për një shkollë të re, pasi që shkolla fillore e cila egziston në fshatin Ponoshec, është shumë e vjetër dhe e vogël, kështu që nuk ka mundësi që të ofrojë kushte për zhvillimin e mësimit sipas rregullave dhe standardeve mësimore. Gjithashtu në shkollën egzistuese ka shumë mungesë të kthinave përcjellëse , si kabinete , hapësira për shumë qëllime, si dhe edhe pse në shkollën egzistuese janë 5 klasë, ato as për së afërmi nuk I plotësojnë kushtet për mbajtjen e mësimit. Ndërtesa e Shkollës fillore “ Ganimete Tërbeshi” është projektuar sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare, dhe si e tillë do të ju ofrojë nxënësve kushte të përshtatshme për mësim .

Kjo Shkollë gjithashtu do të ofrojë edhe hapësirat për parashkollorë, të cilët do të kenë mundësi të kalojnë ditën në këto njësi, sepse në këtë projekt është paraparë edhe kthina për fjetje për fëmijë.

Përveq funksioneve kryesore, në këtë projekt janë paraparë edhe parkingjet për arsimtarë dhe prindër, si dhe do të ketë terene sportive, të cilat janë të rrethuara me gjelbërim, ku nxënësit dhe fëmijët do të kenë mundësi të kenë argëtim dhe rekreacion.

7. Përmbajtja e Projektit

01. Situacioni i Gjërë	1: 500
02. Situacioni i Ngushtë	1: 200
03. Baza e Themeleve - Baza e Bodrumit	1: 100
04. Baza e Përdhesës	1:100
05. Baza e Katit	1:100
06. Fasada e Pestë	1:100
07. Prerja A – A & Prerja B – B	1:100
08. Detajet	1: 10
09. Fasada Ballore & Pasma	1:100
10. Fasada e Djathtë & Majtë	1:100
11. Fasada e Pestë	1:100
12. Pamjet 3 D	